REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 904/20
Datë/Datum. 20.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Nr. i lëndës:*
Hysni Muhadri	12.11.2020	20.11.2020	904/20

NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:09.11.2020, OE "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 904/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për dhënie të kontratës OE "SOLID" SHPK - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me këpucë për PK-në", me numër të prokurimit: 214-20-4467-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës **(PK).**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 804 500,00 €.

Data e njoftimit për kontratë.....19.08.2020.
Data e hapjes së ofertës.....01.10.2020.
Data e njoftimit për vendimin e AK-së.....23.10.2020.
Data e njoftimit si ofertues i papërgjegjshëm.....23.10.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....27.10.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....30.10.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" - Prishtinë, janë:

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 10 – Mjetet për promovimin e Transparencës;
Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës;
Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Pretendimin 1 – Qëllimi Është shumë e rëndësishme që procesi i prokurimit publik të kryhet me sinqeritet, drejtësi, dhe në mënyrë që siguron vlerën më të mirë për paranë publike. AK duhet të jenë efektive në kosto dhe efikase në përdorimin e resurseve dhe njëkohësisht duke respektuar standardet më të larta të integritetit.

Ligji imponon obligime AK-të qe te bëjnë publikimet e njoftimeve, Përdorimin e procedurave të prokurimit të cilat ofrojnë konkurrencë të hapur dhe transparente. Aplikimin e objektivave dhe kritereve të qarta në përzgjedhjen e tenderuesve dhe dhënien e kontratave, përdorimin e specifikimeve teknike jo-diskriminuese;

Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.
Ne këtë raste AK i Policisë se Kosovës e ka bere shkelje te LPP-se ka cekur kriterin me dy kuptime ku ka mundur te cek te sjellen shtate pale këpuca prej 39-44 e jo o jo kështu me dy kuptime kriterin (c) Për Pjesën 1 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë mostra nga një pale këpucë standarde Policore nga numri 39 deri ne 44 sipas spacifikacioneve teknike Aneksit 1 para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve në orën 14 :00) gjithashtu **nuk munden te kërkohen 7 mostra për një artikull** kjo është e pa nevojshme AK i nevojitet vetëm te verifikoj se ka mostrën ne përputhje me specifikat e jo te kërkohen 7 mostra se ato janë te gjitha njësoj.

Gjithashtu arsyet për eliminim nuk qëndrojnë se mostra nuk munden te kërkohen 7 mostra

për një Artikull e sipas AK te Policisë se Kosovës po te ishin 3 artikuj atëherë ne OE 21 pale këpuca është dashur ti sjellim si mostra qe i bije koleksionim te këpucëve, për mendimin tone kjo është e tepërt dhe e pa nevojshme se nuk ka mu vlerësuar numrat e këpucëve 39-44 por materiali i kepeave.

Pretendimin 2 – është here diskriminim pasi nuk është bere vlerësimi real i ofertave dhe nuk janë trajtuar te gjitha ofertat ne mënyrë te barabartë pra, Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente

Pretendimi 3-Kriteret ne dosje e tenderit duhet te jene ne përputhje me nenin 51 te LPP-se Të gjitha këto kërkesa për dokumente dhe mostra do të kërkohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori ekonomik nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 65 të këtij ligji, gjithashtu nese OE përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit atëherë konsiderohet I përgjegjshëm dhe ne kemi dorëzuar një mostër per një artikull po ne mundemi edhe ti kishim pru 7 mostra këtë mundeni te kërkoni ne përputhje me nenin 72 te LPP-se . Nenin 72 mundet te kërkohen te gjitha qe kane te bëjnë nga neni 65-71 te LPP-se.

Po ju citojm nenin: Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkohen ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji.

Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e fitesës për tenderim.

Pretendimi 4-eshte se është shkelur nenin 10 i LPP-se pasi nuk na ka jep qasje ne komplet Aktivitetin e Prokurimit dhe nuk na ka lejuar as ti fotografojmë mostrat e OE Solid shpk si dhe dokumentet tjera te OE SOLID shpk duke thane se nuk bane me shikua kjo u shihet qatë nga zyrtari i Policisë qe nuk lejojë e ne ja kërkuam letrën se a ka sekret afarist tha jo dhe nuk na lejoj me shikua ofertat.

Pretendimi 5 se është shkelur neni 59 pasi nuk është bere vlerësim real i ofertave dhe ne përputhje me LPP-ne.

Pas qasjeve ne dokumente zyrtare sebashku me zyrtarin e prokurimit z. Enver Hysenin arsyeja e eliminimit se nuk është lidhësja e këpucës 80-100 cm nuk qëndron se ne prezencën e këtij zyrtari e kemi matur dhe ka dal 81 cm lidhësja e jone, e jo qysh na kane eliminuar për matje 79 cm te lidhëses. Kur e kame pyetur pse na keni shënuar – eliminuar pa te drejt pa qene kështu na kane thane me shkruar qashtu dhe ju kemi eliminuar.

Gjithashtu arsyeja e eliminimit se rrethi i këpucës duhet te jete me qepje te njefisht kjo nuk qëndron pasi mostra jone këpuca ka qepjen njëfishtë dhe qepja e lëkurës e dyfishtë ndërsa AK ka bere vlerësim subjektiv.

Rrethi kpucës qepja një fisht, sipas specifikave.

Qepja e lëkures dy fishtë

Tek ambalazhimi është ne përputhje me specifikimin teknik qe është kërkuar . Emrin e prodhuesit e ka , llojin e prodhimit e ka, madhësinë e numrin e ka , deklaratën per mënyrën e përdorimit e ka dhe numrin serik e ka por Policia e Kosovës qëllimi ka qene me na eliminuar ne se kemi qene me çmim me te lire. Kërkoj nga eksperti ti shikoj mostrat.

Pretendimi ynë - se është injoruar konkurrenca dhe transparenca pasi kompania A&V Collection NP e jone ka qene me çmim me te lire dhe i ka plotësuar specifikimet teknike se

kemi qene te rekomanduar për kontrate ne herën e pare kjo eshte shkelje e nenit 60 te LPP-se.

Pretendimi ynë 5- është se AK i Policia e Kosovës ka bere kundërshtim me neni 59 te Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit LPP-se.

Pretendimi ynë është se OE i rekomanduar për kontratë Solid shpk nuk plotëson kriterin e kërkuar pasi është kërkuar certifikatë sipas standardit EN ISO 20347 ka sjellë një test raport te lëkurës, mirëpo për lidhësen është kërkuar qe te sjell edhe lidhësen kundër ujit kompania Solid shpk nuk e ka as certifikatën 20347 e as testin për lidhëse.

Pretendim i ynë 6- është se shkelur Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Pretendimi i ynë 7 është se AK i Policisë se Kosovës ka bere shkelje te nenit 69 paragrafi 2 dhe 2.4 pasi ka mundur qe nga OE te kërkohen mostrat tjera po ju citojmë nenin:

2. *Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet furnimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të deshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:*

   2.4 mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen; dhe/ose

Pra ne baze te këtij neni ka mundur te kërkohen edhe seria tjetër e këpucëve pasi është absurdë te kërkohen 7 pale këpucë (komplet seria) për një artikull.

Gjithashtu pretendimi i yni është shkelur neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë pasi ky nen thot se dokumentet qe kane te bejne para publikimit te njoftimit per kontrat e qe kane te bejne nga neni 65-71 munden te kerkohen informata shtes, po e citojm nenin:

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorezojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartesojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Duke u bazuar te gjitha faktet e cekura me larte dhe argumente ku operatori ekonomik i shpallur fitues nuk plotëson kriteret sipas DT , pasi nuk e ka certifikatën EN ISO 20347 si dhe është me i larte me çmim se kompania jone 69,440.00 .

Kërkoj te **aprovohet Ankesa** e kompanisë **B.I Sabit Makiqi – A&V Collection NP** dhe aktiviteti te kthehet ne rivlerësim pasi jemi kompani e përgjegjshme me çmim me te lire.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta me pretendimet e kërkesës për rishqyrtim.

FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c) Vërtetim nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2.* *b) Vërtetim nga Administrata Tatimore.* *c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje e noterizuar.* *d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje e noterizuar.*
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës). b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore). c) Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore). d) Për Pjesën 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë Autorizimi nga prodhuesi Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *a) Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit.* *b) Kopja e certifikatës së TVSH-së.* *c) Kopja e certifikatës së numrit fiskal.* *d) Për Pjesën 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë Autorizimi nga prodhuesi Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit.*

kontrates), nëse OE është i autorizuar nga distributori i prodhuesit duhet te jete bashkangjitur Marrëveshja Konfirmim në mes të distributorit dhe kompanisë prodhuese sedistributori ka drejt te lëshoj autorizim.	
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: a) Për Pjesën 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo te ngjashëm për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum tri kontrata të përfunduar realizuar. b) Për Pjesën 1 prodhuesi i këpucëve duhet te jetë i certifikuar me standardin EN ISO 9001 2015. c) Për Pjesën 1 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë mostra nga një pale këpucë standarde Policore nga numri 39 deri ne 44 sipas spacifikacioneve teknike Aneksit 1 para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve në orën 14:00. d) Për Pjesën 1 Operatori ekonomik duhet te dëshmojë se produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20347. e) Për Pjesën 2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo te ngjashëm për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum një kontrata të përfunduar realizuar. f) Për Pjesën 2 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë mostra për artikullin numër 1 këpuce solemne për femra nga një pale këpucë nga numri 36 deri në 39 sipas spacifikacioneve teknike Aneksit 1, Për artikullin numër 2 këpuce solemne për meshkuj nga një pale këpucë nga numri 41 deri në 43 sipas spacifikacioneve teknike Aneksit 1, mostrat për te dy artikujt duhet te dorëzohen para afatit të fund për dorëzim të tenderëve në orën 14: 00.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *a) Për Pjesën 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit.* *b) Kopje e noterizuar e certifikates EN ISO 9001 2015.* *c) Për Pjesën 1 Mostrat duhen dorëzuar para afatit të fundit për pranimit të ofertave ora 14:00.* *d) Për pjesën 1 Operatori Ekonomik duhet te sjell kopje te certifikatës a po apo Flete inspektim te lëshuar nga ndonjë laborator i certifikuar për inspektime testime te lëkurës).* *e) Për Pjesën 2 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit.* *f) Për Pjesën 2 Mostrat duhen dorëzuar para afatit të fundit për pranimit të ofertave ora 14:00.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, për këtë lende, rekomandon ZP që fitues të shpallet OE "SOLID" SHPK - Suharekë, me çmim të ofruar me vlerë: 658,440.00€.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 23.10.2020.

Operatori ekonomik ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" - Prishtinë, ka ofertuar në vlerë totale të ofertës:589,000.00€.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" - Prishtinë, është eleminuar, shihë arsyetimin:

ARSYETIM

OE është eliminuar pasi nuk ka plotësuar specifikat teknike si ne vijim:
Pjesa 1:
1. Është kërkuar të vijnë mostra nga një palë këpucë nga numri 39 deri 44 (Operatori ne fjale ka sjelle vetëm një palë me numër 43, dhe mungojnë numrat 39,40,41,42 dhe 44)
2. Gjatësia e lidhëseve te këpucëve duhet te jete 80 deri ne 100 cm dhe te jene rezistence ndaj ujit (Pas matjes gjatësia e lidhëses është 79 cm)
3. Qepja ne pjesën e lëkurës duhet te jete e dyfishte, ndërsa rrethi I këpucës duhet te jete me qepje te njëfishtë sipas dizajnit te bashkangjitur (Rrethi I këpucës nuk është me qepje te njëfishtë sipas dizajnit te bashkangjitur)
4. Tek ambalazhimi ku kërkohet qe secila palë e këpucëve duhet te jene te paketuara ne kuti kartoni origjinale te stampuara nga prodhuesi; (Mungon lloji I prodhimit, nuk është I shkruar si dhe mungon numri identifikues serik për te identifikuar datën e dërgesës)
Për arsyeje të lartshënuara OE është eliminuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit tek Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Pjesa 1, është kërkuar:

Numrat e këpucëve nga 35 deri ne 48 me standard EU. Numrat duhet të jene të shënuar në këpucë.

Gjatësia e lidhësve të këpucëve duhet të jetë 80 deri ne 100 cm dhe të jenë rezistuese ndaj ujit.

Qepja ne pjesën e lëkurës duhet të jetë e dyfishtë, ndërsa rrethi i këpucës duhet të jetë me qepje të njëfishtë,sipas dizajnit te bashkangjitur.

Ambalazhimi

Secila pale e këpucëve duhet te jenë te paketuara në kuti kartoni origjinale të stampuara nga prodhuesi:

1. Emri i prodhuesit ,
2. Lloji i prodhimit
3. Madhësia e numrit
4. Deklarata për mënyrën e mirëmbajtjes.
5. Një numër identifikues serik për te identifikuat datën e dërgesës(kjo kërkohet për shkak të garancionit).

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION", në dosjen e tenderit e ka ofruar vetem një mostër të këpucave, pra këpucat me numer 43, shihë dëshminë:

Si dhe paketën e këpuvave ku është etiketa, shihë mëposhtë:

Autoriteti kontraktues pas kërkesës për sqarime të njërit kriter nga njëri nga OE, jepë sqarimë, shihë sqarimin:

Të nderuar,

Më poshtë keni informatat sqaruese për projektin "Furnizim me këpucë për PK-në" me nr. të prokurimit 214-20-4467-1-1-1, 214/20/051/111.

Pyetja 1:

Ne specifikimin teknik Aneksi 1 I DT ceket se këpuca duhet te jete - rrethi i këpucës duhet të jetë me qepje të njëfishtë, sipas dizajnit te bashkangjitur.
Mirëpo keni kërkuar standardin kundër ujit EN ISO 20347 me ketë standard kur te kërkohet nuk lejohet qepje pasi hyn uji. Na kur te sjellim mostrën a duhet sipas standardit te kërkuar EN ISO 20347 apo sipas juve qe e keni cek me qepje të njëfishtë.

Përgjigjja 1:

Nuk është kërkuar të atestohet këpuca për rezistence ndaj ujit sipas standardit EN ISO 20347 pasi që këto këpucë përdorën vetëm gjatë sezonit verore. Lidhëset duhet të jenë rezistuese ndaj ujit.
Kërkesa për Standardin e cekur ka të bëj vetëm me mbrojtje për përdorim si këpucë Profesionale siç edhe është cekur në specifika.

Qepja e njëfishtë nënkupton qepjen e rrethit të jashtëm i cili mund të jetë i dukshëm si dizajn për këpucët Derby apo qepje e brendshme e lëkurës me pjesën e lëkurës së brendshme e cila bashkohet me shollën e cila pastaj mund të çimentohet apo në ndonjë mënyre tjetër të ngjitet për shollës (shputën e këpucës).

Në munges të mostrave përmes e-mailit i drejtohem AK-së me dt:12.11.2020, shihë më poshtë:

← REPLY ← REPLY ALL → FORWARD ···

Mark as unread

Hysni Muhadri
Thu 11/12/2020 10:44 AM

To: ☐ abdurrahman.cunaku@kosovopolice.com;
Cc: ☐ Shqipe Hoti; ☐ Ardian Behra; ☐ Blerim Dina;

I nderuar e kam në shqyrtim një ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnzim me këpuc për PK-në, ku pretendimet ankimore kanë të bëjnë me specifikimet, konkretish me mostrat e kërkuar dhe të dorëzuara nga OE ankues. Sa i pashë mostrat nuk janë të bashkangjitura me ankesën, andaj kërkoj të më sqaroni se si është e mundur me i shiku këto mostra, për të mundur ta japë një përgjigje.

Me respekt:

Hysni Muhadri

Të njejtën ditë AK-së më përgjigjet, shihë më poshtë:

Mark as unread

Abdurrahman Çunaku <abdurrahman.cunaku@KosovoPolice.com>
Thu 11/12/2020 11:14 AM

I nderuar,

Ju lutem mund te vini sot ne ora 13:30 qe te keni qasje ne mostra.

Me respekt !
Abdurrahman Çunaku
UD/ Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit të Policisë së Kosovës,
Rr."Luan Haradinaj"-Nr.99 Ndërtesa e re e Administratës kati i 2-të, zyra nr.29
Tel: 038 504 504 1720

Po të njëjtën ditë shkoj në takim te AK-së,për ti shiqu mostrat, shihë më poshtë:

Qasje ne mostrat e dorëzuar nga OE pjesëmarrës për arkitektin e prokurimit Furnizim me këpucë për PK-ne Pjesa 1 me nr. te prokurimit 214/20/051/111, 214-20-4467-1-1-1 sipas kërkesës se Ekspertit te OSHP-se me emalit te datës 12/11/2020

Gjate qasjes ne dokumentacion prezenti ishin nga Pala:

1. Emri: HYSNI mbiemri: MUHADRI nënshkrimi data 12.11.2020

Ndërsa nga AK zyrtari i prokurimit:

1. Emri: GËZIM mbiemri: HYSENI nënshkrimi data 12/11/2020

Pas analizimit të mostrave, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION", e ka ofruar një mostër të këpucëve me nr 43, pra nuk janë ofruar mostrat e këpucëve me nr 39, 40,41,42 dhe 44, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.
Opertaori ekonomik në fjalë, mund tw konsiderohet e ka ofruar lidhsën e këpucvëe në gjatësi 80 cm, në qoft

se ldhset ngrihen fort nga të dy anët.
Ndërsa sa i përket qepjes së këpucës, siç shihet edhe me lartë në foto, qepja e këpucës lartë tek rrethi është në njëher, ndërsa në mesë këpuca është e qepur dy herë, ndërsa posht tek pjesa e lidhjes së shputës me pjesën e e lëkurës së këpucës, siq shihet në foto dhe pas shiqimet të mostrës, nuk shihet që ka qepje fare.

Në kërkesë është kërkuar: "Qepja nw pjesën e lëkurës duhet të jetë e dyfishtë, ndërsa rrethi i këpucës duhet të jetë me qepje të njëfishtë,sipas dizajnit të bashkangjitur".

Gjithashtu tek sqarimet e AK-së, është sqaruar: "Qepja e njëfishtë nënkupton qepjen e rrethit të jashtëm i cili mund të jetë i dukshëm si dizajn për këpucët Derby apo qepje e brendshme e lëkurës me pjesën e lëkurës së brendshme e cila bashkohet me shollën e cila pastaj mund të çimentohet apo në ndonjë mënyre tjetër të ngjitet për shollës (shputën e këpucës)".

Pra duke pasur parasysh kërkesën e specifikimeve tenike, sqarimet e ofruara nga AK-së, mund të konkludojm se këpuca nuk është ofruar konform këtyre kërkesave.

Nndërsa sa i përket Ambalazhimit, ku kërkohet se secila palë e këpucëve është kërkuar të jetë e paketuar në kuti origjinal dhe e satmpuar nga prodhuesi, emri i prodhuesit , Lloji i prodhimit, Madhësia e numrit, Deklarata për mënyrën e mirëmbajtjes dhe Një numër identifikues serik për te identifikuat datën e dërgesës(kjo kërkohet për shkak të garancionit), eksperti sqyrtues sqaron se pas shiqimit të mostrës, këpucët me nr.43, janë me një ambalazh prej pakete të këpucëve, ku në këtë ambalazh është një logo apo tiket, e cila është e prezantuar më lartë, ku në këtë tiket shënon Fashion – Italia, MALBERTEX si dhe është një numër KODI 1350, andaj duke i parë këto dëshmi, mendoj se nuk është përmbushur kërkesa në fjalë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2
Operatori ekonomik ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "SOLIDI" SHPK, nuk e plotëson kriterin e kërkuar Certifikat sipas standardit EN ISO 20347, sepse ka një testë raport të lëkurës, si dhe është kërkuar Certifikata 20347, për lidhsën kunder ujit, dhe nuk është ofruar certifikata në fjalë dhe as atesti për lidhsen.
Duke u bazuar në të gjitha faktet e cekura më lartë si dhe argumentet, mund të themi se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kriterin e DT, pasi që nuk e ka ofruar Certifikatën EN ISO 20347, si dhë është më i lartë me çmim në vlerë 69,440.00€, se sa kompania jonë.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, tek pika b. është kërkuar *"Për pjesën 1: Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20374"*, tek dëshmit dokumentare është kërkuar: *"Për pjesën 1 Operatori Ekonomik duhet të sjell kopje të certifikatës apo Flete inspektim të lëshuar nga ndonjë laborator i certifikuar për inspektime testime të lëkurës)".*

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "SOLID" SHPK, në dosjen e tenderit e ka ofruar një Test Report, ku në të shënon 20347. Pra te kërkes më lartë përveq Kopjes së certifikatës, SHËNON apo Flete inspektim të lëshuar nga ndonjë laborator i certifikuar për inspektime testime të lëkurës), shihë dëshminë më poshtë:

Via del Tiebolo Nord, 27/29
56029 Santa Croce sull'Arno (Pi), Italia
Tel. 0571 418200 - info@laboratoriobestlab
www.laboratoriobestlab.com - C.F./P.IVA 01246130509

BESTLAB

ACCREDIA
LAB N° 1477 L
Membro degli Accordi di Mutuo Riconoscimento EA, IAF, e ILAC

Data of issue:	15/09/2020
Start measurements:	14/09/2020
End measurements:	15/09/2020

Customer:
STELLITALIA S.r.l.
VIA SANT'ANDREA, 109/E
56029, SANTA CROCE SULL'ARNO, (PI)

Test Report N°202005439

General Data - Provided by the client

Name/Articol:	ALPI
Batch N°:	
Colour:	
Applicant:	SOLID SHOES THERANDE KOSOVE
Type of material:	LEATHER
Intended use:	

Sample Preparation

Date of receipt:	14/09/2020
Sampling:	SAMPLE PROVIDED BY THE CUSTOMER
Preparation and Conditioning:	UNI EN ISO 2419:2012 EN ISO 20347
Notes:	

PHYSICAL TEST RESULTS

TEST METHOD	PARAMETERS	RESULT	U.M.	LIMITS	U	LQ
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER - PENETROMETER - (PENETRATION TIME SAMPLE 1 PARALLEL)	230	min			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER (PENETROMETER) - WATER ABSORPTION	2	%			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER - PENETROMETER - (PENETRATION TIME SAMPLE 2 PARALLEL)	222	min			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER (PENETROMETER) - WATER ABSORPTION	3	%			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER - PENETROMETER - (PENETRATION TIME SAMPLE 3 PERPENDICULAR)	214	min			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER (PENETROMETER) - WATER ABSORPTION	2	%			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER - PENETROMETER - (PENETRATION TIME SAMPLE 4 PERPENDICULAR)	230	min			
UNI EN ISO 5403-1:2012	WATER RESISTANCE OF FLEXIBLE LEATHER (PENETROMETER) - WATER ABSORPTION	4	%			
UNI EN ISO 19074:2015	DETERMINATION OF WATER ABSORPTION FOR CAPILLARITY	23.6	%			
UNI EN ISO 19074:2015	WICKING VALUE OF WATER ABSORPTION FOR CAPILLARITY	26.9	mm			
UNI EN ISO 2589:2016	DETERMINATION OF THICKNESS (MEDIUM VALUE)	1.5	mm			

Notes:

SEE ANNEX MOD. AQ004/PG12 Rev.00 del 09-01-2017
END OF TEST REPORT

Approved by
Head of Laboratory
David Di Sandro

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION", ku pretendon se për lidhëset e këpucëve është kërkuar Certifikata 20347, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION" - Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me këpucë për PK-në", me numër të prokurimit: 214-20-4467-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës ***(PK).***

"SOLID" SHPK, nuk e ka ofruar certifikatën në fjalë dhe as atesti për lidhsen.

Eksperti shqyrues sqaron se tek pika d), është kërkuar: *"Për Pjesën 1 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se produkti i ofruar është në përputhje me standardin EN ISO 20347".*

Ndësa tek përgjigja, pas parashtrimit të pyetjeve të drejtuara AK-së nga njëri OE, autoriteti kontraktues përgjigjet: ***"Nuk është kërkuar të atestohet këpuca për rezistence ndaj ujit sipas standardit EN ISO 20347 pasi që këto këpucë përdorën vetëm gjatë sezonit verore. Lidhëset duhet të jenë rezistuese ndaj ujit. Kërkesa për Standardin e cekur ka të bëj vetëm me mbrojtje për përdorim si këpucë Profesionale siç edhe është cekur në specifika".***

Andaj duke pasur parasysh kërkesën e DT dhe njoftimit për kontratë, sqarimeve të ofruara nga AK-së, mund të themi se askund nuk shënon që lidhset e ofruara duhet të jenë në përputhje me standardin EN ISO 20347.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës **(PK).**
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "SABIT MAKIQI B.I NP A&V COLLECTION"